

Në bazë të nenit 47 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë Nr. 04/L-150, nenit 20.1, 20.4 dhe 22 të Statutit të Odës të Farmacistëve të Kosovës, Kuvendi i Odës të Farmacistëve të Kosovës në mbledhjen e vet të mbajtur më 11.09.2015 miratoi :

## **KODI ETIK PËR FARMACISTË**

### **I. Dispozitat e përgjithshme**

#### **I.1 Kodi etik për farmacistë:**

Kodi etik për farmacistë është reviduar me qëllim të reflektimit të ndryshimeve në legjislacion, ndryshimeve në mënyrën e rregullimit të punës së profesionistëve shëndetësor (themelimi i Odës së Farmacistëve), zhvillimeve të reja në lëminë farmaceutike si dhe nevojës për sigurimin e ofrimit të shërbimeve farmaceutike të bazuar në standarde të kompetencës profesionale.

#### **I.2 Hyrje:**

Farmacisti si profesionist shëndetësor ka diturinë, shkathësinë dhe aftësinë e duhur për menaxhimin dhe përdorimin e barnave, duke mundësuar ofrimin e shërbimit më të mirë të mundshëm farmaceutik. Profesionin e farmacistit përfshin përgatitjen e barnave, menaxhimin e furnizimit me barna si dhe këshillat, ofrimin e informatave rreth barnave dhe monitorimin e përdorimit të barnave nga ana e pacientit. Farmacisti gjatë ofrimit të shërbimeve farmaceutike siguron që pacienti gjithmonë të jetë në qendër dhe të jetë pjesë aktive e vendimmarrjes.

#### **I.3 Kodi Etik**

Zbatimi i pikave të kodit etik është obligativ. Sjellja profesionale dhe personale e farmacistit të regjistruar do të sanksionohet bazuar në pikat e këtij kodi. Farmacisti i regjistruar duhet t'u përmbahet rregullave të përcaktuara me kod pa marrë parasysh punën që kryen. Sjellja e pahijshme, qoftë edhe në rastet kur nuk lidhet drejtpërdrejt me profesionin apo moszbatimi i rregullave të përcaktuara me kod mund të rrezikojnë regjistrimin e farmacistit. Në rastet e shkeljeve ato do të trajtohen nga Këshilli Etik e Odës i cili do të konsideroj rrethanat e rasteve individuale para se të vendos për masat.

## **II. Dispozitat e Kodit Etik**

### **Pika 1 – Pacienti në qendër të fokusit të farmacistit**

*Prioriteti i parë i farmacistit është shëndeti dhe mirëqenia e pacientit*

Obligimet:

- 1.1. Farmacisti gjatë punës së vet është gjithmonë në shërbim të pacientit;
- 1.2. Farmacisti duke e përdorur diturinë e tij profesionale do të ofroj kujdes dhe shërbime në mënyrë të vazhdueshme dhe me respekt ndaj pacientit;
- 1.3. Farmacisti përmes shkathtësive të komunikimit do të identifikojë pacientët me nevoja specifike dhe do të ofroj kujdes dhe shërbime bazuar në ato nevoja;
- 1.4. Farmacisti do të identifikoj rreziqet nga dëmet eventuale që pacienti mund të pësoj nga përdorimi i barnave dhe do të veproj në eliminimin e tyre;
- 1.5. Farmacisti do të merret aktivisht me promovimin e shëndetit dhe mirëqenies së pacientit.

### **Pika 2 – Respektimi i të drejtave të pacientit, integritetit të tij dhe lirisë së zgjedhjes**

*Pacienti ka të drejtë të përfshihet në vendimet që mirren për trajtimin dhe kujdesin ndaj tij.*

Obligimet:

- 2.1. Farmacisti duhet që të respektoj të drejtën e pacientit për vendimmarrje në trajtimin e tij;
- 2.2. Farmacisti duhet të ndërmer hapat e nevojshëm për komunikim efektiv me pacientit dhe të përshtat mënyrën e komunikimit me nevojat e pacientit;
- 2.3. Farmacisti duhet t'i sqaroj pacientit opsionet e mundshme të trajtimit apo kujdesit, duke përfshirë rreziqet dhe dobitë në mënyrë që pacientit t'i mundësohet zgjedhje e arsyeshme për të;
- 2.4. Farmacisti duhet të ruaj dhe respektoj konfidencialitetin e informatave të siguruar rreth pacientit;
- 2.5. Farmacisti nuk duhet të përfshihet në marrëveshje apo marrëveshje biznesi e cila do t'a cenonte të drejtën e pacientit për përzgjedhje të trajtimit apo të kujdesit shëndetësor.

### **Pika 3 – Ndërmarrja e vendimeve profesionale në interes të pacientit**

*Vendimi profesional duhet të jetë i bazuar në evidencë, protokole ekzistuese dhe në impaktin financiar që vendimi do të ketë te pacienti.*

Obligimet:

- 3.1.Farmacisti duhet të veproj në interesin më të mire të pacientit.
- 3.2.Farmacisti gjatë marrjes së vendimit profesional nuk duhet të ndikohet në asnjë rrethanë nga interesi personal apo financiar;
- 3.3.Farmacisti duhet të përdor të gjitha burimet e mundshme në dispozicion për ofrimin e shërbimit profesional;
- 3.4.Farmacisti duhet të intervenoj dhe të komunikoj me profesionistët tjerë shëndetësor në rastet kur identifikon problem të mundshëm që do të cenonte trajtimin apo kujdesin e suksesshëm të pacientit;
- 3.5.Farmacisti në raste emergjente duhet të ndërmerr hapat e nevojshëm për ofrimin e ndihmës ndaj pacientit dhe atë brenda kompetencave profesionale.

#### **Pika 4 – Zhvillimi i profesionit dhe edukimi i vazhdueshëm profesional**

*Farmacisti duhet jetë i përkushtuar për zhvillimin dhe përparimin e profesionit dhe do të kujdeset për edukim të vazhdueshëm profesional të vetin*

Obligimet:

- 4.1. Farmacisti duhet që aktivisht të merr pjesë në zhvillimin dhe përparimin e profesionit;
- 4.2. Farmacisti duhet që të përkrah aktivitetet që kanë të bëjnë me zhvillimin dhe përparimin e profesionit;
- 4.3. Farmacisti duhet që të identifikoj dhe adresoj nevojat e veta dhe të tjerëve në zhvillimin e vazhdueshëm profesional.

#### **Pika 5 – Bashkëpunimi dhe marrja e përgjegjësive**

*Farmacisti si profesionist shëndetësor duhet të siguroj bashkëpunim efektiv me profesionistët e lëmive tjera shëndetësore dhe të jetë i gatshëm për marrjen e përgjegjësive për punën e kryer.*

Obligimet:

- 5.1. Farmacisti duhet që të komunikoj dhe bashkëpunoj me kolegë nga profesioni dhe nga profesionet tjera shëndetësore në të mire të trajtimit apo kujdesit ndaj pacientit;

5.2. Farmacisti duhet të merr përgjegjësi për punën e kryer nga vet ai apo nga personi nën mbikqyrje të drejtpërdrejtë të tij;

5.3. Farmacisti duhet të siguroj që veprimet apo sjelljet e tij nuk do të pengojnë punën profesionale të tjerëve;

5.4. Farmacisti duhet të siguroj që në vendin e punës të ketë procedurat e shkruara rreth ankesave të mundshme dhe të njoftoj palët për ato;

5.5. Farmacisti duhet të reagoj në rastet kur identifikon se procedurat, kushtet e punës apo performanca profesionale ndikojnë negativisht në sigurinë apo shëndetin e pacientit.

### **Pika 6 – Promovimi i besueshmërisë së publikut ndaj farmacistit dhe kujdesi për reputacionin e profesionit**

*Farmacisti si anëtar i një profesioni të privilegjuar dhe të respektueshëm do të punoj dhe veproj në atë mënyrë që do të siguroj besimin e plotë të pacientit dhe mbaj reputacionin e profesionit.*

Obligimet:

6.1. Farmacisti duhet të veproj me sinqeritet dhe integritet;

6.2. Farmacisti nuk do të përdor pozitën e tij profesionale me qëllim të shfrytëzimit të mungesës së njohurisë të tjerëve;

6.3. Farmacisti duhet që në mënyrë të hapur, të sinqertë dhe me kohë t'u përgjigjet ankesave dhe kritikave;

6.4. Farmacisti do të evitoj mundësinë e konfliktit të interesit dhe do t'a lajmëroj atë në të gjitha rastet;

6.5. Farmacisti do të blej, shes apo promovoj vetëm ato produkte për të cilat është i sigurt se produktet i përmbushin kriteret e përcaktuara ligjore;

6.6. Farmacisti do të siguroj që pacienti apo konsumatori nuk do të ketë qasje dhe mundësi që të ketë kontakt fizik me barnat të cilat përshkruhen me recetë që janë të ekspozuara në barnatore;

6.7. Farmacisti në asnjë rast nuk do të veproj në atë mënyrë që të promovoj mbipërdorimin e barnave.

